INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
KOSOVAR INSTITUTE FOR POLICY RESEARCH AND DEVELOPMENT

INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Serbe është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat serbe.

PËRKRAHUR NGA:

OPEN INFORMATION PARTNERSHIP

Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT SERBE

Korrik 2020

HYRJE

Lajmëruesit e Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Serbe synojnë t'i kundërvihen dezinformatave përmes monitorimit në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që origjinën e kanë në Serbi. Mediat e përzgjedhura janë Tanjugu, Informeri, Novosti, Kuriri, B92-shi, Politika dhe Naša Borba, të cilat janë të njohura për dhënien e lajmeve me përmbajtje dezinformuese, dhe të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në Kosovën.

Monitorimi i këtyre mediave ka treguar që gjatë muajit korrik 2020, botimet e sipërpërmendura mediale të përzgjedhura me origjinë në Serbi, kanë botuar një total prej 493 lajmesh që kanë patur të bëjnë me Kosovën, ku Tanjugu i ka botuar 48, Beta 53, Informeri 45, Novosti 62, Kuriri 21, B92-shi 220, Politika 38, dhe Naša Borba 6 artikuj lidhur me Kosovën.

Një shqyrtim i kujdesshëm i këtyre artikujve ka treguar që lajmet e botuara gjatë kësaj periudhe nga Beta, Kurir dhe Naša Borba nuk kanë patur ndonjë përmbajtje me dezinformata serioze. Mirëpo, botimet e tjera të përzgjedhura mediale kanë patur një numër relativisht të madh të lajmeve dhe artikujve me përmbajtje dezinformuese për Kosovën. Përballë këtij sfondi, KIPRED-i është përqendruar në dekonstruktimin e dezinformatave më flagrante të lëshuara nga mediat serbe të dhëna më sipër, gjë kjo që do të diskutohet në pjesën në vijim.

Qëllimi i dezinformatave të bëra gjatë kësaj periudhe monitoruese nga mediat e përzgjedhura serbe në raport me Kosovën ka qenë i përqendruar në mohimin e krimeve serbe të luftës dhe vilktimave e të zhdukurve në Kosovë, denigrimin e intervenimit të NATO-s dhe Ambasadorit William Walker, denigrimin e drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë, denigrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gjermanisë kinse kanë bërë marrëveshje të fshehtë për blerje të tankeve "Leopard II".

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE MË FLAGRANTE TË DETEKTUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

> ***Titulli:*** *Italijanska novinarka: Kosovo je crna rupa [Gazetarja Italian: Kosova është një vrimë e zezë],* ***B92, 29 Korrik, 2020***[1]

Artikulli flet për një intervistë të zhvilluar në Kosova Online me gazetaren dhe shkrimtaren Italiane, Marija Lina Veka[2], e cila flet për situatën në Kosovë dhe e quan atë si "vrimë e zezë". Në në mes të tjerash në intervistën e Veka dezinformon në mënyrë eklatante për dy çështje:

Së pari, ajo deklaron se Kosova është një shtet i paligjshëm, ku ka mungesë të sundimit të ligjit, ku nuk njihen krimet e kryera nga UÇK-ja dhe Nato-ja, dhe se ka mungesë të hetimeve për zhdukjen e rreth 2000 serbëve në Kosovë.

Së dyti, Veka deklaron se 300 deri 500 serbë janë viktima të heqjes së organeve vitale, të destinuara për tregti ndërkombëtare dhe se të gjitha dëshmitë për rrëmbim, vrasje, trafikim organesh janë zhdukur[3].

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) "Krimet e Nato-s dhe zhdukja e 2000 serbëve në Kosovë"

Në bazë të Fondit për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd dhe zyrën e saj në Prishtinë, gjatë luftës të viteve 1998-1999 në Kosovë kishte më shumë se 13 mijë 500 persona të vrarë dhe të zhdukur, me ç'rast 10 mijë e 794 persona kanë qenë shqiptarë, 2 mijë e 197 persona kanë qenë

[1] Italijanska novinarka: Kosovo je crna rupa: https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2020&mm=07&dd=29&nav_category=640&nav_id=1712277
[2] Ibid
[3] Ibid

serbë, dhe të tjerët janë nga komunitet e tjera jo shumicë.[4] Për gjitha këto krime e luftës në Kosovë deri me sot ka pasur hetime, gjykime dhe dënime nga gjykatat ndërkombëtare dhe vendore[5], dhe ate më së shumëti të të inkriminuarve nga komuniteti shqiptarë. Ndërsa sa i përket çështjes "së mosnjohjes së krimeve të kryera nga NATO-ja" një gjë e tillë nuk është as pak e vërtetë, pasi NATO nuk ka kryer as një krim në ish Jugosllavi gjatë bombardimit si dhe gjatë pranisë së saj në Kosovë si mision paqeruajtës. Nga ana tjetër, gjatë bombardimit të NATO-s në Kosovë, ushtria dhe policia e Serbisë civilet i kishte përdorur si "mburojë njerëzore" duke i vendosur në pozicionet e tyre ushtarake ku ata ishin të vendosur[6] dhe si pasoj kishte civilë të vrarë[7] nga ana e NATO-s, por ata nuk ishin cak i sulmeve të tyre.

Sa i përket deklaratës se "nuk ka hetim për 2000 qytetar serbë të zhdukur"[8]. Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës për Persona të Zhdukur në bazë të ligjit nuk i trajton as një rast të zhdukur në baza të etnisë, gjinisë, prejardhje kombëtare etj[9]. Mirëpo, duhet theksuar që, Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës për Persona të Zhdukur, në përgjigjejen e dërguar Institutit KIPRED-it ka deklaruar se në Kosovë janë ende edhe 1640 perona të zhdukur "ku 70 përqind janë shqiptarë dhe 30 përqind janë komunitete të tjera si serb, turq, romë etj". Në bazë të kësaj, shohim që shumica e personave të zhdukur janë shqiptarë dhe jo serbë, prandaj deklarata se "nuk ka hetim për 2000 qytetar serbë të zhdukur"[10] është tërësisht dezinformuese.

[4] Radio Evropa e Lire, Dokumentimi i krimeve të luftës, misioni I papërmushur në Kosovë, https://www.evropaelire.org/a/dokumentimi-i-krimeve-te-luftes-mision-i-papermbushur-ne-kosove/29865017.html

[5] Radio Evropa e Lire, Të dënuar për krime lufte në Kosovë, 34 shqiptarë dhe 4 serbë, https://www.evropaelire.org/a/te-denuarit-per-krime-lufte/29563538.html

[6] Amnesty International: NATO/Federal Republic of Yugollavia "collateral Damage" or Unlawful Killings?, Human shields page 8, https://amnesty.no/natofederal-republic-yugoslaviacollateral-damage-or-unlawful-killings

[7] Ibid

[8] Italijanska novinarka: Kosovo je crna rupa: https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2020&mm=07&dd=29&nav_category=640&nav_id=1712277

[9] Përgjigjëje dërguar Institutit KIPRED nga Komisioni Qeveritar I Reoublikës së Kosovës për Persona të Zhdukur, Ligji nr. 03/L 023 Për Persona të Zhdukur Neni 3.

[10] Ibid

b) "300 deri 500 serbë janë viktima të heqjes së organeve vitale"

Akuza për trafikim të organeve njerëzorë gjatë periudhës 1998-1999 ishin përmendur disa raporte pas përfundimit të luftës ne Kosovë[11], ndërsa me 12 dhjetor 2010, Dick Marty kishte prezantuar raportin për trafikim me organe të njerëzve pran Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës[12]. Raporti pretendonte për "trajtim çnjerëzor ndaj njerëzve dhe vrasja e të burgosurve me qëllim largimin dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës"[13]. Mirëpo, deklarata e Kryeprokurorit të Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS), Clint Williamson, e hedh poshtë plotësisht se ka me qindra persona të cilët ishin rrëmbyer, largimin dhe trafikimin e organeve. Ku me date 29 korrik 2014 kryeprokurori Clint Williamson kishe deklaruar se:

"Deklaratat që janë dhënë nga disa njerëz duke lënë të kuptohet që qindra njerëz janë vrarë për qëllimin e trafikimit të organeve janë krejtësisht e pambështetura nga të dhënat që ne kemi dhe që Dick Marty kishte. Nëse vetëm një njeri iu nënshtrua një praktike aq tmerruese, dhe ne besojmë se një numër i vogël iu nënshtruan, kjo është një tragjedi e tmerrshme dhe fakti që kjo ndodhi në një shkallë të kufizuar nuk e pakëson egërsinë e një krimi të tillë. Por, gjithashtu nuk vlen të stërmadhohen shifrat dhe të krijohet dhimbje dhe ankth të pamerituar për familjet të cilat ende nuk e dinë fatin e të dashurave të tyre, duke i shtyrë të imagjinojnë këtë dimension të shtuar të tmerrit"[14]

Në bazë të kësaj deklarate të kryeprokurori Clint Williamson, e kuptojmë të vërtetën se nuk ka as një fakt se me qindra njerëz ju kanë nënshtruar "largimit dhe trafikimit të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", dhe se dyshohet për një numër shumë të vogël të rasteve të tilla.

---

[11] Bakaninsight.com, Kosovo Organ-Trafficking: Hoe the Claims were Exposed, https://balkaninsight.com/2015/09/04/kosovo-organ-trafficking-how-the-claims-were-exposed-09-04-2015-1/

[12] Parliamentary Assembly, Council of Europe: Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo, http://www.assembly.coe.int/CommitteeDocs/2010/ajdoc462010prov.pdf

[13] Ibid

[14] Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force 29 Julay 2014, file:///C:/Users/PC/Desktop/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: *Mediji: Angela dala zeleno svetlo, Nemci naoružavaju Kosovo [Mediat: Angela dha dritën jeshile, gjermanët po e armatosin Kosovë]* ***B92, 22 Korrik, 2020***[15]

Në muajin korrik 2020, pothuajse në të gjitha mediat e Serbisë si B92, Novosti, Informer, Tanjug dhe Politika kanë raportuar për deklaratën e Marko Gjuriqit, Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, se autoritetet e Kosovës kanë negociuar me Inteligjencën e Gjermanisë për blerjen e armëve[16] duke përfshirë këtu edhe blerjen e tankeve gjermane "Leopard II"[17]. Ai po ashtu deklaron se me shitjen e armëve Kosovës, Gjermania ka shkelur kushtetutën dhe ligjet e veta. Marko Đurić, gjatë intervistës bënë edhe deklaratë ofenduese ndaj shqiptareve të Kosovës duke thënë se " është mirë t'u dërgosh libra shqiptarëve në Kosovë, me tanke nuk do të hyjnë kurrë ne KB"[18]

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Instituti KIPRED, ka dërguar kërkesë zyrtare pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës në lidhje me deklaratën e Marko Gjuriqit se Kosova po negocion blerjen e tankeve "Leopard II" nga Gjermania e publikuar në mediat serbe. Në përgjigjen e marrur nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, Kolonel Sefer ISUFI, Zv. Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun ka dërguar një raport të detajuar ku argumenton se gjithçka ka të bëjë me "lajme të rreme" dhe "dezinformuese" nga mediat serbe dhe ruse[19] dhe ate si vijon:

---

[15] B92.net, Mediji: Angela dala zeleno svetlo, Nemci naoruzavaju Kosovo, https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2020&mm=07&dd=22&nav_category=640&nav_id=1709605

[16] Ibid

[17] Politika.rs, Немачка преговара о продаји оружја косовским Албанцима, http://www.politika.rs/scc/clanak/459010/Nemacka-pregovara-o-prodaji-oruzja-kosovskim-Albancima

[18] Novosti.rs, MARKO ĐURIĆ PORUČIO NATO ČLANICAMA: Bolje Albancima na KiM pošaljite knjige, tenkovima nikada neće ući u UN, https://www.novosti.rs/vesti/politika/905065/marko-djuric-porucio-nato-clanicama-bolje-albancima-kim-posaljite-knjige-tenkovima-nikada-nece-uci

[19] Përgjigjeje përmes postes elektronike nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, e dërguar nga Kolonel Sefer ISUFI Zv. Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun.

a) Forcës së Sigurisë së Kosovës që nga themelimi, ka marrëveshje me NATO-n, ku brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së funksionon Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s (NALT)[20], i cili kryen detyrat si më mëposhtme:

- këshillojë - përfshirë në fushat e ndërtimit të kapaciteteve, trajnimit, udhëheqjes, doktrinës, logjistikës, ligjit ndërkombëtar, të drejtave të njeriut dhe menaxhimit;
- asiston - përfshirë praktikat më të mira sipas standardeve ndërkombëtare për çështje të tilla si strategjitë e zyrave qendrore, politikat, proceset e planeve dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm që sigurojnë transparencë dhe përgjegjësi;
- ndërlidhin dhe koordinojnë Programet e Ndihmës së NATO-s.

Në këtë pikë, gjithçka është transparente dhe nuk ka as një marrëveshje sekrete për blerjen e armatimit nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, pasi që të veprimet e saj dhe FSK-ës bëhen në koordinim me Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s, ku dhe vetë Gjermania është anëtare.

b) Gjatë vizitës të Kryeministrit te Kosovës z. Avdullah Hotit në Ministrin e Mbrojtjes dhe FSK-ës, kishte deklaruar se "Unë sot jam këtu për të demantuar çfarë do lajmi që është publikuar ne media ndërkombëtare, në lidhje me furnizimin me armatim që ka pasuar FSK-ja"[21]. Po ashtu gjatë kësaj vizite, Forca e Sigurisë së Kosovë, z. Hoti i prezantuan edhe automjetet e blera HMMWV nga Shtete e Bashkuara të Amerikës.[22]

   Ndërsa Ministri i Mbrojtjes z. Anton Çuni gjatë këtij takimi me Kryeministrin e Kosovës kishte deklaruar se "lufta speciale që po e bëhet në mediat ruse, se gjoja FSK-ja, ka blerë armatim fshehurazi nga Gjermania në vlerë deri në 170 milion euro, të gjitha këto sipas ministrit Quni bëhen për të destabilizuar paqen në Ballkan, dhe për të krijuar pretekst për

[20] Nato.int: Nato Advisory and Liaison Team (NALT), https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_144933.htm
[21] Deklarata e Kryeministrit te Kosoves z. Avdulllah Hoti ne Kazermen e FSK-es Adem Jashari, https://www.youtube.com/watch?time_continue=6&v=4H-wFf5M6QI&feature=emb_title
[22] Ibid

armatosjen e mëtejme të Serbisë, si dhe duke tentuar të kompromet ojë bashkëpunimin tonë të mirë dhe transparent me shtetin e Gjermanisë"[23].

c) Buxheti vjetor i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2020 është 69,275,842 Euro, për vitin 2021 69,693,026 Euro dhe për vitin 74,360,087 Euro[24]. Me këto projekcione buxhetore Ministria e Mbrojtjes e ka të pamundur që të blejë paisje dhe mjete ushtarake me vlera të mëdha, e aq më pak që të bëjë blerje të tyre me vlerë qindra milionëshe.

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: ĐURIĆ: Voker treba da odgovara zajedno sa liderima OVK! [ĐURIĆ: Walker duhet të përgjigjet së bashku me drejtuesit e UÇK-*së],* ***Informer, 10 Korrik, 2020[25]***

Artikulli e thekson deklaratën e Drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, i cili pretendon që William Walker është përgjegjës për provokimin e luftës në Kosovë dhe "agresionin" e NATO-s kundër ish-Jugosllavisë. Djuric e cilëson William Walkerin si kriminel dhe "një pjesë integrale e të ashtuquajturës UÇK dhe një nga frymëzuesit dhe krijuesit ideologjikë të luftës në Kosovë".

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Duke përpjekur që t'i mohojë krimet serbe gjatë luftës në Kosovë, Marko Djuric akuzon ish ambasadorin amerikan dhe kryesuesin e Misionit Verifikues për Kosovën[26], William Walker si

[23] Ibid
[24] LAW ON THE BUDGET APPROPRIATIONS OF THE REPUBLIC OF KOSOVO FOR YEAR 2020, https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EA0446D5-97E0-4540-A9CB-73521FD245A9.pdf
[25] ĐURIĆ: Voker treba da odgovara zajedno sa liderima OVK!, https://informer.rs/vesti/politika/532853/djuric-voker-treba-odgovara-zajedno-liderima-ovk.
[26] OSCE Kosovo Verification Mission / OSCE Task Force for Kosovo (closed), https://www.osce.org/kvm-closed.

përgjegjës për provokimin e luftës në Kosovë dhe agresionin kundër ish-Jugosllavisë, duke aluduar në masakrën e Reçakut dhe intervenimin e NATO-s në Kosovë.

Sa i përket rolit të William Walker gjatë luftës në Kosovë, duhet theksuar që pjesëtarët e Misionit Verifikues për Kosovën kishin për detyrë të mbikëqyrnin armëpushimin mes forcave serbe dhe UÇK-së, dhe ata kishin mundësi vetëm që të përcillnin dhe të raportonin për ngjarjet, pa mundësi që të parandalonin ndonjë gjë, pasi për këtë nuk i kishin as pajisjet, fuqinë apo mandantin e nevojshëm[27]. Sa i përket pretendimit në lidhje me 'provokimin' e luftës nga Ambasadori Walker, duhet theksuar që masakra e Reçakut si dhe dështimi i Marrëveshjes së Rambujesë ishin momente kthesës në luftën e Kosovës të cilat në fund kulmuan me intervenimin e NATO-s. Me 15 janar 1999, në fshatin Reçak të komunës së Shtimes, forcat policore dhe ushtarake serbe vranë 45 civilë shqiptarë[28], ndërsa Shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së për Kosovën, ambasadori William Walker e cilësoi këtë veprim të forcave serbe si "krim kundër njerëzimit,"[29]. Këto gjetje u konfirmuan edhe nga ekipi finlandez i forenzikës i dërguar nga Unioni Europian për të hetuar vrasjet në Reçak. Udhëheqësja e Ekipit Hetues Finlandez, Dr. Helen Ranta, deklaroi se kishin ardhur në përfundim që viktimat ishin civilë të paarmatosur dhe e cilësoj këtë veprim si "krim kundër njerëzimit."[30]

Lajmërim i Dezinformatës 4

Titulli: SKANDAL U GNjILANU: Konzulat Crne Gore smešten u krugu fabrike za duvan, počasni konzul saradnik Ramuša Hardinaja, Novosti, 24 Korrik, 2020[31]

Artikulli pretendon se Mali i Zi ka shkaktuar skandal si dhe ka cenuar Konventen e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore përmes emërimit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

[27] Joschka Fischer, Vitet kuq-gjelbër, Botimet Koha, 2008, f.118.
[28] MASAKRA QË NDRYSHOI HISTORINË E KOSOVËS, https://www.evropaelire.org/a/masakra-qe-ndryshoi-historine-e-kosoves/30376954.html.
[29] Për më tepër shih, https://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/interviews/walker.html.
[30] Massacre a `crime against humanity' in Kosovo, https://www.irishtimes.com/news/massacre-a-crime-against-humanity-in-kosovo-1.164160.
[31] SKANDAL U GNjILANU: Konzulat Crne Gore smešten u krugu fabrike za duvan, počasni konzul saradnik Ramuša Hardinaja, https://www.novosti.rs/vesti/politika/904496/skandal-gnjilanu-konzulat-crne-gore-smesten-krugu-fabrike-duvan-pocasni-konzul-saradnik-ramusa-hardinaja.

Gazmend Abrashi si konsull nderi në Kosovë. Sipas artikullit një konsull nderi nuk mund të jetë një politikan.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Ky artikull është dezinfomim i plotë, meqë nuk kemi të bëjmë me skandal diplomatik pasi Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore[32] nuk parasheh ndalesa për emërimin si konsull nderi të politikanëve. Çështja e konsujve të nderit është e rregulluar në kapitullin e tretë (III) të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore. Këto dispozita të konventës nuk parashohin në asnjë formë ndalesa konkrete për ushtruesit e funksioneve politike që të emërohen si konsuj të nderit, për më tepër çdo shtet mund të vendos lirshëm se a dëshiron të emëroje apo pranojë konsuj të nderit[33]**.** Po ashtu, duhet theksuar që është i çuditshëm fakti që artikulli ka kthyer në fokus këtë çështje pavarësisht faktit që hapja e konsullatës është bërë më shumë se një vit më parë. Në maj të vitit 2019, Mali i Zi kishte marrë vendim për hapjen e konsullatës së nderit në Gjilan[34]**,** ndërsa me 2 korrik 2019 ishte bërë hapja e konsullatës në Gjilan si dhe emërimi i Gazmend Abrashit si konsull nderi[35]**.**

[32] Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/9_2_1963.pdf.
[33] Ibid, neni 68.
[34] Mali i Zi hap konsullatë në Gjilan, https://gazetametro.net/mali-i-zi-hap-konsullate-ne-gjilan/.
[35] Mali i Zi me konsullatë nderi në Gjilan, https://2lonline.com/mali-i-zi-me-konsullate-nderi-ne-gjilan/.